

Vula Apostile

- Të gjitha dokumentet e nevojshme austriake, të cilat kërkohen apo paraqiten tek institucionet shqiptare, duhet të jenë origjinale dhe të pajisura me Vulën Apostile, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë në Austri apo Shqipëri. Pajisja e dokumenteve me Vulë Apostile në Austri, bëhet pranë zyrave të posaçme në çdo qeveri Landi (Landesregierung).
- Të gjitha dokumentet e nevojshme shqiptare, të cilat kërkohen apo paraqiten tek institucionet austriake, duhet të jenë origjinale dhe të pajisura me Vulën Apostile, si dhe të përkthyer në gjuhën gjermane nga përkthyes zyrtarë në Austri. Pajisja e dokumenteve me Vulë Apostile në Shqipëri, bëhet pranë zyrës së posaçme të Drejtorisë Konsullore, në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë.